



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
*Sesioni pranveror*

Kryesia e Kuvendit

P-028  
Prishtinë, më 11 prill 2018, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 11 PRILL 2018

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Aida Dërguti, Slavko Simiq dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj, Musli Krasniqi dhe Osman Shatri.

**Nga EUSR-ja:** Blerta Bejtullahu dhe

**Nga OSBE-ja:** Sanije Berisha.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe katër (4) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës dhe
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

#### **1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme e Kryesisë së Kuvendit**

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 27 shkurt, 5, 9, 14, 15 e 21 mars dhe 4 prill 2018

#### **2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës**

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet për shqyrtim në seancë plenare.

Lidhur me përgatitjet për seancën plenare të radhës dhe për datën e mbajtjes së saj diskutuan: Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së dhe Albert Kinolli në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Me propozim kryetarit të GP Deputetët e Pavarur, Dardan Sejdiu, u shty propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe të Grupit të “Deputetëve të Pavarur” për kryesimin e komisioneve parlamentare, si dhe përfaqësimin e tyre në komisionet parlamentare.

Kryesia e Kuvendit pasi diskutoi për përgatitje e seancës plenare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të hënën, më 16 prill 2018, në orën 10:00, me këtë:

## **Rend dite**

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-061 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjykatat,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,*
8. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtaritë hidrometeorologjike,*
9. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës,*
10. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,*
11. *Shqyrtimi i raportit të operatorit të sistemit, transmisionit dhe tregut - KOSTT sh. a,*
12. *Përzgjedhja e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,*
13. *Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë (6) anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,*
14. *Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës,*
15. *Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve,*
16. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve,*
17. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë,*
18. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02/34, datë 5. 3. 2018, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion euro për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës,*
19. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar Deputetët e Pavarur, në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë “Contour Global” dhe Qeverisë së Kosovës për projektin e Termocentralit “Kosova e Re”, të nënshkruar më 20 dhjetor 2017,*
20. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës,*

21. Interpelanca e ministrit të Shëndetësisë, z. Uran Ismajli, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me sistemin informativ shëndetësor dhe sigurimet shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës,

22. Debat parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me të gjeturat e raportit të Komisionit Shtetëror për Shënjin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror,

23. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetëve Ganimete Musliu, Salih Salihu dhe Driton Çausi, në lidhje me skandalin e mishit të prishur të ardhur nga Belgjika, si dhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë,

24. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, e mbështetur edhe nga 11 deputetë nënshkrues, në lidhje me korrupsionin si kriter për liberalizim të vizave, dhe

25. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 5 deputetë nënshkrues, në lidhje me sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë.

\* \* \*

Gjithashtu, lidhur me pikën 16 të lartcekur të rendit të ditës, u nxor ky:

## P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga Grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 16 prill 2018, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë nga radhët e komunitetit shqiptar të Komisionit të Pavarur të Medieve.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë si në vijim: GP i AAK-së, (Kryetarin); GP i LDK-së, (zëvendëskryetarin e parë dhe 1 anëtar); GP i PDK-së, (2 anëtarë); GP i LVV-së, (2 anëtarë); GP Deputetët e Pavarur, (1 anëtar); GP i Listës serbe, (zëvendëskryetarin e dytë); GP i Nismës Socialdemokrate, (1 anëtar) dhe GP "6+", (1 anëtar).

### **3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave**

*1. Vendimi i Presidentit për kthimin e Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi vendimin e lartshënuar, nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal që ta shqyrtojë Vendimin e Presidentit lidhur me kthimin e Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare për rishqyrtim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime në afatin prej dy javësh.

*2. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave*

Kryesia, pasi diktoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si Komision FunkSIONAL, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

*3. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar*

Kryesia, pasi diktoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin në Vlerën e Shtuar t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si Komision FunkSIONAL, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

*4. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale*

Kryesia, pasi diktoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/ L-028 për tatimin në të ardhurat personale t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si Komision FunkSIONAL, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

*5. Nisma legislative Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete, e hartuar nga deputeti Mërgim Lushtaku dhe i mbështetur nga 9 deputetë*

Kryesia, pasi e shqyrtoi nismën e lartshënuar, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete, si dhe ta përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afat prej një (1) muaji nga dita e pranimimit.

*6. Nisma legislative Projektligji për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme, e hartuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje*

Kryesia, pasi e shqyrtoi nismën e lartshënuar, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative Projektligji për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afat prej një (1) muaji nga dita e pranimimit.

*7. Shqyrtimi i Propozim-Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2019-2021*

Kryesia, pasi shqyrtoi Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2019-2021, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2019-2021.

2. Ministria e Financave të njëjtën ta përfshijë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2019-2021.

*8. Shqyrtimi i Propozimit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për zgjedhjen e nënkryetares së Kuvendit nga radhët e këtij grupi parlamentar*

Kryetari i njoftoi të pranishmit me propozimin e GP të Lëvizjes Vetëvendosje për zgjedhjen e znj. Albulena Haxhiu nënkryetare të Kuvendit nga radhët e këtij grupi.

Lidhur me propozimin e lartcekur të GP të LVV-së diskutoi Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së, diskutimi i të cilit është i dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi për propozimin e lartshënuar, nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

1. Kryesia e Kuvendit nuk ka kompetencë ta zgjedhë nënkryetarin e Kuvendit dhe as ta shkarkojë nënkryetarin e Kuvendit.

2. Procedura për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit dhe procedura për shkarkimin e nënkryetarit të Kuvendit është e përcaktuar më nenin 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe më nenet 12 dhe 14 të Rregullores së Kuvendit.

*9. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për mbajtjen e debatit parlamentar në lidhje me të gjeturat e raportit të Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror*

Kryesia e radhiti kërkesën e lartshënuar në rend dite të seancës plenare më 16 prill 2018.

*10. Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Ganimete Musliu, e mbështetur edhe nga 13 deputetë nënshkrues, për debat parlamentar në lidhje me skandalin e mishit të prishur të ardhur nga Belgjika (Kompania Veviba)*

*11. Shqyrtimi i kërkesës së deputetëve: Salih Salihu dhe Driton Çausi, të mbështetur edhe nga 10 deputetë nënshkrues, për debat parlamentar në lidhje me cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë*

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të PDK-së dhe të Deputetëve të Pavarur vendosi që për këto dy kërkesa e lartshënuara për debat parlamentar të shqyrtohen me një pikë të përbashkët në seancë plenare, më 16 prill 2018.

*12. Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, e mbështetur edhe nga 11 deputetë nënshkrues, për debat parlamentar në lidhje me korrupsionin si kriter për liberalizim të vizave*

Kryesia e radhiti kërkesën e lartcekur për debat parlamentar në rend të ditës për seancën plenare, më 16 prill 2018.

*13. Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 5 deputetë nënshkrues, për debat parlamentar në lidhje me sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë*

Kryesia e radhiti kërkesën e lartcekur për debat parlamentar në rend të ditës për seancën plenare, më 16 prill 2018.

*14. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Administratë Publike Qeverisje Lokale dhe Medie për vazhdimin e afatit kohor për shqyrtimin e Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën*

Kryetari i njoftoi të pranishmit se në ndërkohë komisioni funksional i lartshënuar e ka përfunduar shqyrtimin e Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën.

*15. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel (Belgjikë)*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Sala Berisha-Shala dhe Dardan Sejdiu, u lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel (Belgjikë), prej 23-25 prill 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa nga Komiteti i Energjisë do të mbulohen shpenzimet e akomodimit, me mundësi të rimburesimit edhe të shpenzimeve të udhëtimit.

*16. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar të delegacionit të Kuvendit të Kosovës në SHBA*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Safete Hadërgjonaj, Doruntinë Maloku-Kastrati, Vjosa Osmani-Sadriu, Fisnik Ismaili dhe Xhevahire Izmaku u lejohet udhëtimi zyrtar në Uashington DC (SHBA), prej 14-18 prill 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*17. Shqyrtimi i kërkesës për aprovimin e pjesëmarrjes në konferencën ndërparlamentare në Beograd*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:



## V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Ganimete Musliu, Salih Salihu, Sërgjan Mitroviq dhe Blerta Deliu-Kodra u lejohet udhëtimi zyrtar në Beograd (Serbi), prej 12-14 prill 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit (me tejkalim të shpenzimeve në bazë të rezervimeve paraprake) dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*18. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Elmi Reçica për lejimin e udhëtimit zyrtar në Mbretërinë e Bashkuar*

Kryetari i njoftoi të pranishmit se deputeti z. Reçica e ka parashtruar kërkesën e lartshënuar më herët, por në mungesë të mbajtjes së mbledhjes së Kryesisë nuk është proceduar dhe deputeti tani më është në këtë udhëtim zyrtar.

Më pas, Kryesia e konfirmoi lejimin e udhëtimit zyrtar të deputetit z. Reçica, si dhe mori këtë:

## V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Elmi Reçica, i lejohet mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar në Mbretërinë e Bashkuar, nga 7-11 prill 2018.

*19. Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së Komisionit për Integritet Evropian, Blerta Deliu-Kodra, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Beograd*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Blerta Deliu-Kodra, i lejohet udhëtimi zyrtar në Beograd (Serbi), prej 10-13 maj 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*20. Shqyrtimi i kërkesës për mbështetje financiare për z. Bekim Lumi, regjisor dhe profesor i Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Bekim Lumi mbështetet financiarisht në shumën prej 4 999 euro për trajtimin shëndetësor të tij.

2. Mjetet e parapara në pikën një (1) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere dhe transferohen në xhirollogarinë bankare të z. Bekim Lumi.

*21. Njoftimi i deputetes Donika Kadaj-Bujupi për tërheqjen nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje dhe nga pozita e kryetares së Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë*

Kryesia u njoftua me shkrim nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi, se ajo nga data 14 mars 2018 është tërhequr nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje dhe aktivitetin e saj parlamentar do ta vazhdojë në GP të AAK-së, si dhe që është tërhequr edhe nga pozita e kryetares së Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

*22. Njoftimi i Komisionit për Integritet Evropian lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Maqedoni, prej 25-27 shkurt 2018*

Kryesia e Kuvendit u njoftua me shkrim nga Komisioni për Integritet Evropian lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar në Maqedoni, nga 25-27 shkurt 2018.

*23. Njoftimi i Grupit Parlamentar Nisma për Kosovën lidhur me ndërrimin e emrit të Partisë politike*

Kryesia e Kuvendit u njoftua me shkrim nga Grupi Parlamentar i Nismë për Kosovën se kjo parti e ka ndërruar emrin e saj nga Nisma për Kosovën me akronimin Nisma, në Nisma Socialdemokrate me akronimin Nisma, si dhe për kërkesën që ky grup parlamentar me emrin e ri të identifikohet edhe në ueb-faqe dhe në dokumentet tjera të Kuvendit.

*24. Njoftimi i deputetit Armend Zemaj lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Bullgari*

Kryesia e Kuvendit u njoftua me shkrim nga deputeti Armend Zemaj lidhur me udhëtimin zyrtar të tij të realizuar në Bullgari, nga 18-20 mars 2018.

*25. Njoftimi i delegacionit të Kuvendit të Kosovës lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Maqedoni*

Kryesia e Kuvendit u njoftua me shkrim nga delegacioni i Kuvendit të Kosovës, në përbërje nga deputetët Driton Selmanaj, Safete Hadërgjonaj, Dardan Molliqaj dhe Andin Hoti, lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar në Maqedoni, më 26 shkurt 2018.

*26. Informata e Administratës së Kuvendit të Kosovës lidhur me mirëmbajtjen higjienike dhe atë teknike të ndërtesës së Kuvendit të Kosovës*

Kryesia e Kuvendit u njoftua me shkrim nga Administrata e Kuvendit lidhur me kompaninë “MSS”, e cila i ka kryer shërbimet e mirëmbajtjes së hapësirave në Kuvendin e Kosovës.

**Pikat shtesë:**

*1. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Grupit Parlamentar të Listës serbe, Sasha Milosavljeviq, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Austri dhe Gjermani*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Sasha Milosavljeviq, i lejohej udhëtimi zyrtar në Austri dhe Gjermani, prej 14-19 prill 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e akomodimit mbulohen nga organizatori.

*2. Shqyrtimi i kërkesës për aprovim të shpenzimeve me rastin e vizitës zyrtare të delegacionit të Asamblesë Kombëtare të Kuvajtit në Republikën e Kosovës*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për delegacionin Grupit të Miqësisë nga Asambleja Kombëtare e Kuvajtit gjatë vizitës zyrtare në Kosovë, prej 11-15 prill 2018, sipas kërkesës nr. 06/1040/Do-594, datë 11. 4. 2018.

*3. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Slavko Simiq, për lejimin e pagesës të faturave në shumën prej 361 euro*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Slavko Simiq, për lejimin e pagesës, në shumën prej 361,00€, sipas faturave të bashkangjitura në kërkesën me nr.06/1057/Do-600, datë 11. 4. 2018.

#### *4. Përzgjedhja e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës*

Kryesia e radhiti përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rend të ditës për seancën plenare, më 16 prill 2018.

\* \* \*

Në fund, kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti, propozoi që në seancën e radhës të radhitet edhe formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas rekomandimeve të nxjerra nga Kuvendi i Kosovës më 4 prill 2018 në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova, më 29 mars 2018.

Lidhur me propozimin e lartcekur të diskutuan: Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP Deputetët e Pavarur, si dhe Ismet Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës, diskutimet e të cilëve janë në transkript.

Pas diskutimeve, Kryesia e Kuvendit lidhur me formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit që ta përgatisë një opinion ligjor lidhur me atë se kush ka të drejtë ta kryesojë Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova më 29 mars 2018 dhe Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesë raportin lidhur për këtë çështje.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*